



Duke u bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032 dhe në Ligjin për Arsimin dhe Arsimin Profesional dhe në Udhëzimin Administrativ Nr.22/2013 për Numrin dhe Afërsimin Profesional të nxënësve për klasën dhe raportin mësimdhënës nxënës, Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec shpall:

Nr. I prot. 1114 Më Dt. 21.08.2023  
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

## KONKURS

(plotësues)

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) NË SHKOLLAT E MESME TË LARTA TË KOMUNËS SË RAHOVECIT PËR VITIN SHKOLLOR 2023/2024

### 1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, në gjimnaze dhe IAAP, për vitin shkollor 2023/24, mund të konkurojnë nxënësit, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë përfunduar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë njohjen e dëftesave në MASHTI dhe më pastaj të konkurojnë për regjistrim.

### 2. Dokumentet e nevojshme për konkurim

Nxënësit për të konkuruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe në IAAP, duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkuron)
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Certifikatën e lindjes.

### 3. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe IAAP për vitin shkollor 2023/2024, bëhet në datat, 22,23, dhe 24 gusht në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën, 25.08.2023. Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej datës 27.08.2023.

Nxënësi i pakënaqur me rezultatin e publikuar, ka të drejtë ankese brenda (2) dy ditë pune, nga koha e shpalljes së rezultateve.

Ankesa parashtrohet në drejtorinë e shkollës. Ankesat e shkollës së dytë bëhen në Drejtorinë Komunale të Arsimit brenda (2) ditë pune, pas pranimit të përgjigjes nga shkolla.

## A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kritere:

- |   |               |
|---|---------------|
| 1. Sukses nga shkollimi i obliguar      | (40%) 40 pikë |
| 2. Sukses nga lëndët prioritare në test | (20%) 20 pikë |
| 3. Numri i pikëve nga testi             | (40%) 40 pikë |

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 pikë

Kriteri i lëndëve prioritare nga sukseesi për gjimnaze dhe shkollat e mesme të mjekësisë është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë 4.00 (së pari llogaritet mesatarja e lëndëve veç e veç, pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve).

Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjimnaze dhe shkollat e mesme të mjekësisë është minimumi i 40% i pikëve në ato lëndë.

1. Nxënësi nga sukseesi i përgjithshëm i shkollimit të të obligueshëm (kl. 6,7,8,9) mund t'i fitojë maksimalisht 40 pikë.

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

$$\text{Sukseesi (kl.6+kl. 7+ kl.8+ kl.9)} \times 2 = 40 \text{ pikë max}$$

- Nxënësi nga sukseesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 20 pikë  
*Mesatarja e lëndës(I) + mesatarja e lëndës (II) + mesatarja e lëndës (III) + mesatarja e lëndës (IV) = 20 pikë max.*
- **Lëndët me prioritet në sukses sipas drejtimeve të gjimnazeve**
  - a. Gjimnazi i shkencave natyrore: Fizikë , Kimi, Biologji, Matematikë.
  - b. Gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore: Gjuhë amtare, Gjuhë angleze, Histori, Gjeografi.

#### Lëndët me prioritet në sukses sipas profileve të IAAP

- a. **Shëndetësi, Bujqësi, Teknologji Ushqimore dhe Veterinari:**  
Biologji, , Kimi, Fizikë, Gjuhë Shqipe dhe Letërsi
- b. **Makineri, Elektroteknikë, TIK, Tekstil, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë, Komunikacion, Kimi-teknologji, PTT: Fizikë, Kimi, Biologji, Matematikë.**  
Matematikë, Informatikë, Fizikë, Gjuhë Shqipe dhe Letërsi.
- c. **Juridik dhe administratë:**  
Edukatë qytetare, Histori, Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, Gjeografi.
- d. **Tregti, Hoteleri dhe Turizëm:**  
Edukatë qytetare, Histori, Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, Gjeografi.
- e. **Shkollat Artistike:**  
Gjuhë amtare dhe Letërsi, Histori, Edukatë qytetare. Art, Muzikë  
**Drejtimi Pedagogjik-Profil bashkëpunëtor muzikor:**  
Nxënësi duhet të ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl, IX) dhe testin kombëtar.  
**Drejtimi instrumental:**  
Nxënësi duhet të ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl, IX) dhe shkollën e ulët të muzikës (kl. I-VII), në klasën e VII të shkollës së muzikës mund të regjistrohen vetëm nxënësit që kanë të përfunduar shkollën e ulët të muzikës (kl, I-VI).  
Të gjithë nxënësit që do të regjistrohen në klasën e dhjetë, duhet t'i nënshtrohen provimit pranues nga komisioni i shkollës.

#### 4. Kriteri i suksesit të notave në lëndët prioritare për drejtimet përkatëse:

- Gjimnazi i shkencave natyrore- Mesatarja e lëndëve: Fizikë, Kimi, Biologji dhe Matematikë së paku duhet të jetë 4 (katër), si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në testë (20 pikë nga lëndët fizikë, kimi dhe biologji).

$$\text{mes (kimi) + mes (Biologji) + mes (Fizikë) + mes (Matematikë) = 4}$$

- Gjmnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore- Mesatarja e lëndëve: Gjuhë shqipe, Gjuhë angleze, Histori, Gjeografi së paku duhet të jetë 4 (katër) si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test ( 20 pikë nga lëndët histori, gjeografi dhe edukatë qytetare).

$$\text{mes (Gjuhë Shqipe)} + \text{mes (Gjuhë Angleze)} + \text{mes (Histori)} + \text{mes (Gjeografi)} = 4$$

---

4

- Shkollat e shëndetësisë- Mesatarja e lëndëve: Fizikë, Kimi, Biologji dhe Gjuhë amtare së paku duhet të jetë 4 (katër), si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (20 pikë nga lëndët fizikë, kimi dhe biologji)

$$\text{mes (kimi)} + \text{mes (Biologji)} + \text{mes (Fizikë)} + \text{mes (Gjuhë Shqipe)} = 4$$

---

4

B. Përbajtja e testit- numri i kërkesave (pyetjeve) sipas lëndëve:

**I. Gjuhë**

- |                  |         |                    |
|------------------|---------|--------------------|
| 1. Gjuhë shqipe  | 35 pikë |                    |
| 2. Gjuhë angleze | 15 pikë | (Gjithsej 50 pikë) |

**II. Shkencat shoqërore**

- |              |         |                    |
|--------------|---------|--------------------|
| 1. Gjeografi | 25 pikë |                    |
| 2. Histori   | 25 pikë | (Gjithsej 50 pikë) |

**III. Matematikë**

- |                |         |                    |
|----------------|---------|--------------------|
| 1. Matematikë  | 35 pikë |                    |
| 2. Informatikë | 15 pikë | (Gjithsej 50 pikë) |

**IV. Shkencat natyrore**

- |             |         |                    |
|-------------|---------|--------------------|
| 1. Fizikë   | 17 pikë |                    |
| 2. Kimi     | 16 pikë |                    |
| 3. Biologji | 17 pikë | (Gjithsej 50 pikë) |

**4. Renditja e lëndëve me prioritet në test sipas drejtimeve të gjmnazeve:**

**I. Gjmnazi shkencat e natyrës:**

- |                                      |                         |
|--------------------------------------|-------------------------|
| 1. Shkencat e natyrës 50             | 50x0.4=20 pikë          |
| 2. Matematikë dhe Informatikë 50     | 50x0.2=10 pikë          |
| 3. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 50 | 50x0.15=7.5 pikë        |
| 4. Shkencat shoqërore 50             | 50x0.05=2.5 pikë        |
|                                      | <b>Totali = 40 pikë</b> |

**II. Gjmnazi shoqëror gjuhësor:**

- |                                      |                         |
|--------------------------------------|-------------------------|
| 1. Shkencat shoqërore 50             | 50x0.4=20 pikë          |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 50 | 50x0.2=10 pikë          |
| 3. Matematikë dhe Informatikë 50     | 50x0.15=7.5 pikë        |
| 4. Shkenca natyrore 50               | 50x0.05=2.5 pikë        |
|                                      | <b>Totali = 40 pikë</b> |

**1. Renditja e lëndëve me prioritet sipas profileve në IAAP**

**I. Shëndetësi, Bujqësi dhe Veterinari:**

- |                                      |                             |
|--------------------------------------|-----------------------------|
| 1. Shkencat natyrore 50              | $50 \times 0.4 = 20$ pikë   |
| 2. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze 50 | $50 \times 0.2 = 10$ pikë   |
| 3. Matematikë dhe Informatikë 50     | $50 \times 0.15 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkencat shoqërore 50             | $50 \times 0.05 = 2.5$ pikë |
|                                      | <b>Totali = 40 pikë</b>     |

**II. Makineri, Elektroteknikë, Gheodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji. Grafikë dhe Komunikacion, Kimi-Teknologji**

- |                                      |                             |
|--------------------------------------|-----------------------------|
| 1. Matematikë dhe Informatikë 50     | $50 \times 0.4 = 20$ pikë   |
| 2. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze 50 | $50 \times 0.2 = 10$ pikë   |
| 3. Shkenca natyrore 50               | $50 \times 0.15 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkenca shoqërore 50              | $50 \times 0.05 = 2.5$ pikë |
|                                      | <b>Totali = 40 pikë</b>     |

**III. Ekonomi**

- |                                      |                             |
|--------------------------------------|-----------------------------|
| 1. Matematikë dhe Informatikë 50     | $50 \times 0.4 = 20$ pikë   |
| 2. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze 50 | $50 \times 0.2 = 10$ pikë   |
| 3. Shkenca natyrore 50               | $50 \times 0.15 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkenca shoqërore 50              | $50 \times 0.05 = 2.5$ pikë |
|                                      | <b>Totali = 40 pikë</b>     |

**IV. Juridik**

- |                                      |                             |
|--------------------------------------|-----------------------------|
| 1. Shkencat shoqërore 50             | $50 \times 0.4 = 20$ pikë   |
| 2. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze 50 | $50 \times 0.2 = 10$ pikë   |
| 3. Matematikë dhe informatikë 50     | $50 \times 0.15 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkenca natyrore 50               | $50 \times 0.05 = 2.5$ pikë |
|                                      | <b>Totali = 40 pikë</b>     |

**V. Tregëti, Hoteleri dhe Turizëm**

- |                                      |                             |
|--------------------------------------|-----------------------------|
| 1. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze 50 | $50 \times 0.4 = 20$ pikë   |
| 2. Shkenca shoqërore 50              | $50 \times 0.2 = 10$ pikë   |
| 3. Matematikë dhe informatikë 50     | $50 \times 0.15 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkencat natyrore 50              | $50 \times 0.05 = 2.5$ pikë |
|                                      | <b>Totali = 40 pikë</b>     |

**PLANIFIKIMI I REGJISTRIMIT TË NXËNËSVE NË KLASAT E (10-ta- gjimnaze) PËR  
VITIN SHKOLLOR 2023/24, (konkursi plotësues)**

| Nr. | Emri i shkollës         | Vendi   | Drejtimi                       | Numri i paraleleve | Nr. i nxënësve në klasë | Gjithësej nr. i nxënësve |
|-----|-------------------------|---------|--------------------------------|--------------------|-------------------------|--------------------------|
| 1   | SHML"Xhelal Hajda-Toni" | Rahovec | Gjimnazi i Sh. Natyrore        | 4                  | 32                      | 128                      |
|     |                         |         | Gjimnazi i Shkencave Shoqërore | 2                  | 32                      | 63                       |
|     |                         |         | <b>TOTAL</b>                   | <b>6</b>           | <b>32</b>               | <b>191</b>               |

| Nr. | Emri i shkollës   | Vendi   | Drejtimi                       | Numri i paraleleve | Nr. i nxënësve në klasë | Gjithësej nr. i nxënësve |
|-----|-------------------|---------|--------------------------------|--------------------|-------------------------|--------------------------|
| 2   | SHML"Ukshin Hoti" | K.Madhe | Gjimnazi i Sh. Natyrore        | 3                  | 32                      | 80                       |
|     |                   |         | Gjimnazi i Shkencave Shoqërore | 3                  | 32                      | 77                       |
|     |                   |         | <b>TOTAL</b>                   | <b>6</b>           | <b>32</b>               | <b>157</b>               |

| Nr. | Emri i shkollës | Vendi  | Drejtimi                       | Numri i paraleleve | Nr. i nxënësve në klasë | Gjithësej nr. i nxënësve |
|-----|-----------------|--------|--------------------------------|--------------------|-------------------------|--------------------------|
| 3   | SHML"12 Maji"   | Ratkoc | Gjimnazi i Sh. Natyrore        | 2                  | 32                      | 64                       |
|     |                 |        | Gjimnazi i Shkencave Shoqërore | 3                  | 32                      | 87                       |
|     |                 |        | <b>TOTAL</b>                   | <b>5</b>           | <b>32</b>               | <b>151</b>               |

|                              |           |           |            |
|------------------------------|-----------|-----------|------------|
| <b>Gjithësej: (Gjimnaze)</b> | <b>17</b> | <b>32</b> | <b>499</b> |
|------------------------------|-----------|-----------|------------|

**PLANIFIKIMI I REGJISTRIMIT TE NXENESVE NE KLASAT E (10-ta- profesionale) PER  
VITIN SHKOLLOR 2023/24 (konkursi plotësues)**

| Nr.               | Emri i shkollës     | Vendi          | Drejtimi                          | Profili     | Numri i paraleleve | Nr. i nxënësve në klasë | Gjithësej nr. i nxënësve |
|-------------------|---------------------|----------------|-----------------------------------|-------------|--------------------|-------------------------|--------------------------|
| 1                 | SHML"Uksh in Hotii" | Krushë e Madhe | Makineri, prodhim dhe ndërtimtari | Automekanik | 1                  | 28                      | 23                       |
| <b>Gjithësej:</b> |                     |                |                                   |             | <b>1</b>           |                         | <b>23</b>                |

| Nr.               | Emri i shkollës | Vendi  | Drejtimi                         | Profili                  | Numri i paraleleve | Nr. i nxënësve në klasë | Gjithësej nr. i nxënësve |
|-------------------|-----------------|--------|----------------------------------|--------------------------|--------------------|-------------------------|--------------------------|
| 2                 | SHML"12 Maji"   | Ratkoc | Ekonomi, administrim dhe juridik | Asistent i Administratës | 1                  | 28                      | 23                       |
| <b>Gjithësej:</b> |                 |        |                                  |                          | <b>1</b>           |                         | <b>23</b>                |

| Nr. | Emri i shkollës                | Vendi   | Drejtimi   | Profili   | Numri i paraleleve | Nr. i nxënësve në klasë | Gjithësej nr. i nxënësve |
|-----|--------------------------------|---------|--|---|--------------------|-------------------------|--------------------------|
| 3   | IAAP"Selajdin Mullaabazi-Mlci" | Rahovec | Ekonomi, administrim dhe juridik                 | Kontabilist   | 1                  | 28                      | 8                        |
|     |                                |         |  | Asistent i administratës                            | 1                  | 28                      | 7                        |
|     |                                |         | Makineri, prodhim dhe ndërtimtari                | Instalues i ujës-jellësit, kanalizimit dhe ngrohjes | 1                  | 28                      | 23                       |
|     |                                |         |  | Teknik i sistemeve të TIK-ut                        | 1                  | 28                      | 9                        |
|     |                                |         | Agrokulturë, pylltari, peshkatori dhe veterinari | Përpunues i ushqimit dhe profesionet e ngjajshme    | 1                  | 28                      | 21                       |
|     |                                |         | Shërbime   | Asistent restoranti                                 | 1                  | 28                      | 26                       |
|     |                                |         | Shëndeti dhe mirëqenia                           | Bashkëpunëtor profesional i infemierisë             | 1                  | 25                      | 6                        |
|     |                                |         | <b>Gjithësej: (Profesionale)</b>                 |   |                    |                         | <b>9</b>                 |

Rahovec më:

21.08.2023



Avni Morina, Drejtor